

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me objekt:

“Krijimi i sistemit informatik për menaxhimin e aboneve të pensionistëve”.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **14,583,333** (katërmëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

*Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **157,063.36** (Njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë tridhjetë e gjashtë) euro pa tvsh*

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në 14/08/2026 është 92.85 Lekë/Euro.**

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 39, pika 1 përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 42, pika 1 dhe 2 përcaktohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Për sa më lart, nëpërmjet këtij Procesverbali argumentojmë se:

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë ka vendosur të zhvillojë procedurën e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar pa e ndarë në lote, pasi referuar zërave në preventim për objektin: **“Krijimi i sistemit informatik për menaxhimin e aboneve të pensionistëve”**, AK e ka të pamundur teknikisht ndarjen e këtij objekti në lote të veçantë.

Gjithashtu sqarojmë se referuar dokumentacionit teknik pjesë e DST, konkretisht Specifikimeve Teknike dhe Preventivit, qartazi përcaktohet se proceset e punës për këtë objekt janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën dhe AK e ka të pamundur të përcaktojë paraprakisht se cilat volume duhet t’i nënshtrohen procesit të ndarjes.

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 14, parashikohet se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, citohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Për sa më lart, legjislacioni i prokurimit publik, ndër të tjera ka parashikuar dhe mundësinë për Operatorët ekonomik (të cilën nuk plotësojnë kërkesat teknike apo ekonomike veçmas) që të bashkohen me shoqëri të tjera me qëllim përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në DST.

Në këtë rast legjislacioni i prokurimit publik nuk kërkon një formë të veçantë ligjore të bashkimit të shoqërive duke nxitur në këtë mënyrë dhe pjesëmarrjen e Operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit.

Nga ana teknike arsyetimi për mosndarjen në lote të kësaj procedure është si më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se objekti i prokurimit “Krijimi i sistemit informatik për menaxhimin e Aboneve të Pensionistëve” nuk është teknikisht i përshtatshëm për t'u ndarë në lote,

pasi komponentët e parashikuar në këtë procedurë përbëjnë një zgjidhje të vetme, të integruar dhe funksionalisht të pandashme.

Objekti përfshin analizimin e kërkesave, projektimin, zhvillimin dhe implementimin e sistemit informatik, testimin, integrimin dhe konfigurimin e pajisjeve të skanimit, importimin e të dhënave ekzistuese, trajnimin e përdoruesve, dorëzimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij për një periudhë 24-mujore. Këto veprimtari janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sekuenciale me njëra-tjetrën, ku rezultati i një faze përbën input teknik për fazën pasardhëse. Termat e referencës parashikojnë pikërisht faza të njëpasnjëshme të zhvillimit, testimit, trajnimit, dorëzimit dhe më pas mirëmbajtjes së të njëjtit sistem.

Gjithashtu, sistemi duhet të jetë kompatibël si me 40 pajisjet ekzistuese të skanimit të Autoritetit Kontraktor, ashtu edhe me pajisjet e reja që do të furnizohen gjatë zbatimit të kontratës. Në këtë kuptim, pajisjet e skanimit nuk përbëjnë një furnizim të pavarur, por janë komponent funksional i procesit të regjistrimit, identifikimit dhe verifikimit të pensionistëve në sistem. Për këtë arsye, ndarja e tyre nga zhvillimi i sistemit do të krijonte risk për kompatibilitetin hardware–software, integrimin, testimin dhe përcaktimin e përgjegjësisë në rast të mosfunksionimit.

Mosndarja në lote është gjithashtu e nevojshme për të garantuar përgjegjësi të unifikuar teknike gjatë gjithë ciklit të jetës së sistemit. Kontraktori që zhvillon dhe implementon sistemin duhet të mbajë përgjegjësi edhe për funksionimin e tij, integrimin me pajisjet, korrigjimin e defekteve, përditësimet dhe respektimin e niveleve të shërbimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes. Dokumenti parashikon se mirëmbajtja përfshin të gjithë komponentët e sistemit, diagnostikimin e problematikave, kontrollin e funksionaliteteve dhe log-eve, përditësimet dhe ndërhyrjet sipas SLA-së.

Në rast të ndarjes së këtyre komponentëve ndërmjet operatorëve të ndryshëm ekonomikë, do të krijohej një fragmentim i përgjegjësisë teknike, veçanërisht në rastet e incidenteve apo mosfunksionimit, ku do të ishte e vështirë të përcaktohej nëse problematika buron nga aplikacioni, konfigurimi, integrimi me pajisjet e skanimit apo komponentë të tjerë. Një situatë e tillë do të rriste kohën e diagnostikimit dhe zgjidhjes së incidenteve dhe do të cenonte respektimin e afateve të përcaktuara në SLA, të cilat për problematikat kritike parashikojnë kthim përgjigjeje brenda 10 minutash, ndërhyrje në vend brenda 1 ore dhe zgjidhje brenda 4 orësh.

Një tjetër element i rëndësishëm është se kodi burim dhe dokumentacioni teknik i sistemit do t'i dorëzohen Autoritetit Kontraktor, ndërsa kodi duhet të mbahet i përditësuar edhe gjatë periudhës së mirëmbajtjes. Për këtë arsye, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit nga operatorë të ndryshëm do të krijonte varësi teknike, vështirësi në administrimin e versioneve të kodit, përgjegjësi të mbivendosura dhe rrezik për integritetin dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjes.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ndarja e objektit në lote do të sillte vështirësi të konsiderueshme teknike dhe operative në koordinimin e operatorëve, integrimin e komponentëve, testimin, përcaktimin e përgjegjësive dhe garantimin e niveleve të shërbimit.

Për rrjedhojë, realizimi i objektit nga një operator ekonomik i vetëm siguron ndërveprueshmëri të plotë të komponentëve, përgjegjësi të unifikuar, administrim më efikas të kontratës dhe funksionim të qëndrueshëm e të sigurt të sistemit.